REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA HIMARË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4923 prot. Himarë, më 02.07.2025

**VENDIM**

**Nr. 27 , Datë 27.06.2025**

**PËR**
**"DHËNIEN E MIRATIMIT PËR FILLIMN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE PREJ 1.74 HA NË EKONOMINË PYJORE "MALI I PILURIT ÇIKË", NGASTRA 69, ZK:3813 NË FAVOR TË Z. BARDHOSH ÇELOLESKAJ"**

**AKTIVITETI:**

**"AGROPYLLTARI"**

Bazuar ne ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe nenit 54; VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar "Për transferimin në pronësi të bashkive te pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive", ligjin 57/2020, date 30.04.2020 "Për Pyjet", neni 5; VKM nr. 592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor"; V.K.M-në nr.888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit , proçedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre; me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë: Këshilli bashkiak pasi shqyrtoi materialin e sjell nga Kryetari Bashkisë e miratoi me shtatëmbëdhjetë ( 17 ) vota pro , një ( 1 ) kundër , zero ( 0 ) abstenim dhe si më poshtë,

**VENDOSI:**

1.Dhënien e miratimit për fillimn e procedurave për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 1.74 ha në ekonominë pyjore "Mali i Pilurit Çikë", ngastra 69, ZK:3813 në favor të Z. Bardhosh Çeloleskaj për aktivitetin "AGROPYLLTARI".

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për ngritjen e urdhrave përkatës për zbatimin dhe ndjekjen e të gjithë hapave procedurialë ligjorë të këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar ne ligjin nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjev1vendore", neni 55 pika 6.

**KRYETARI**
**Dhimitër Kapaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HIMARË -